



# **AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

## **Përditësime Sigurie – Android**

Data: 03/03/2026  
Version: 1.0

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive .....	1
Informacione Teknike .....	1
Rekomandime .....	2
Referenca .....	2

### Përmbledhje Ekzekutive

---

Google ka publikuar Buletinin e Sigurisë Android për Mars 2026, duke adresuar dobësi të shumta që prekin pajisjet Android. Përditësimet përfshijnë rregullime për dobësi kritike të **Remote Code Execution (RCE)**, **Elevation of Privilege (EoP)**, **Information Disclosure (ID)** dhe **Denial of Service (DoS)** në Framework, System, Kernel dhe komponentë të ndryshëm hardware.

### Informacione Teknike

---

#### Dobësi e Shfrytëzuar Aktivisht

##### CVE-2026-21385

- Rrezikshmëria: E lartë
- Komponenti: Qualcomm Display Driver
- Ndikimi: Korrupsion i memories
- Statusi i shfrytëzimit: Mund të jetë nën shfrytëzim të kufizuar dhe të targetuar

Kjo dobësi buron nga alokimi i pasaktë i memories brenda një komponenti të ekranit Qualcomm.

Shfrytëzimi me sukses mund të komprometojë integritetin e pajisjes për shkak të ndikimit në komponentë bazë hardware.

#### Dobësi Kritike

##### CVE-2026-0006

- Komponenti: System
- Rrezikshmëria: Kritike
- Përshkrim: Dobësi Remote Code Execution (RCE) që mund të lejojë komprometimin e pajisjes pa ndërveprim nga përdoruesi ose privilegje shtesë.

##### CVE-2026-0047

- Komponenti: Framework
- Rrezikshmëria: Kritike
- Përshkrim: Dobësi Elevation of Privilege (EoP) që nuk kërkon ndërveprim nga përdoruesi.

#### Patch Level: 2026-03-05

## Dobësi Kritike të Rëndësishme

- **CVE-2026-0038 – Hypervisor**
- **CVE-2026-0027 – Protected Kernel-Based Virtual Machine (pKVM)**

Këto dobësi prekin mekanizmat e virtualizimit dhe sandboxing që janë përgjegjës për izolimin e aplikacioneve dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive.

## Rekomandime

---

AKSK rekomandon përditësimin e pajisjeve Android në versionin më të fundit.

## Referenca

---

[Android Security Bulletin—March 2026](#) | [Android Open Source Project](#)